



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/54
Datë: 30.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 41 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 9 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Shtetëror i Pranimit për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese, në këtë përbërje:
 - 1.1. Lulzim Ejupi, Sekretar i Përgjithshëm i MPB-së, kryesues;
 - 1.2. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MM-së, anëtare;
 - 1.3. Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MI-së, anëtar;
 - 1.4. Florent Tahiraj, ekspert i jashtëm - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar;
 - 1.5. Jehona Lushaku, eksperte e jashtme - Përfaqësuese e Shoqërisë Civile, anëtare.
2. Komisioni i emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi ka një mandat 2 (dy) vjeçar.
3. Anëtarët nga pika 1,4 dhe 1.5 e këtij Vendimi kanë të drejtën e kompensimit sipas nenit 11 të Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.
4. Komisioni Shtetëror i Pranimit i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtroj në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Pranimi
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik /MPB
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/54

Datë: 30.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 49 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 23 paragrafi 1 i Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Punëve të Brendshme, Kryesues;
 - 1.2. Shepen Trdeva, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë, anëtar;
 - 1.3. Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MI-së, anëtar;
 - 1.4. Enver Krasniqi, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar;
 - 1.5. Hivzi Jetullahu, Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
2. Këshilli ka mandat 5-vjeçar, me përjashtim të anëtarëve nga pika 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 e këtij vendimi, njëri prej të cilëve, i zgjedhur me short, ka mandat një (1) vjeçar dhe zëvendësohet për çdo vit në bazë të shortit nga kandidatët në listat si në paragrafin 3 dhe 8 të nenit 9 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.
3. Anëtarët nga pika 1,4 dhe 1.5 e këtij Vendimi kanë të drejtën e kompensimit sipas paragrafit 7 të nenit 23 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.
4. Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do ti ushtroj në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Drejtorit të Departamentit të Menaxhimit për Zyrtarët Publik
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/54

Datë: 30.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1, dhe neni 43 paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "KRU Mitrovica Sh.A." në përbërje të:
 - 1.1. Bahri Kalludra- Drejtor, kryesues;
 - 1.2. Destan Rrahmani- anëtar;
 - 1.3. Riza Shala- anëtar;
 - 1.4. Besim Shyti- anëtar.
2. Emërimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi bëhet pas skadimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
3. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i emëruar në Ndërmarrjen Publike Qendrore "KRU Mitrovica Sh.A.", shërben në cilësinë e Bordit të Drejtorëve me mandat sipas nenit 43, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- KRU Mitrovica Sh.A.
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/54

Datë: 30.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1, dhe neni 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "KRU Gjakova Sh.A." në përbërje të:
 - 1.1. Burim Shala- Drejtor, kryesues;
 - 1.2. Mirsad Duraku- anëtar;
 - 1.3. Vilson Dura- anëtar;
 - 1.4. Gardalin Shtavica- anëtar.
2. Emërimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi bëhet pas skadimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
3. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i emëruar në Ndërmarrjen Publike Qendrore "KRU Gjakova Sh.A.", shërben në cilësinë e Bordit të Drejtorëve me mandat sipas nenit 43, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- KRU Gjakova Sh.A.
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/54

Datë: 30.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 dhe 22 të Ligjit Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rekomandimi i Komisionit Ndërministror për Investime Strategjike me Nr. 9608, i datës 24.12.2020, për dhënien e statusit investitor strategjik për subjektin investues "Cicavica Wind Farm 1 L.L.C".
2. Emri i projektit investues është "CICAVICA WIND FARM".
3. Vlera e kapitalit të investimit strategjik është 100,620,000.00 € brenda periudhës pesë (5) vjeçare.
4. Emri i investitorit është "Cicavica Wind Farm 1 L.L.C".
5. Projekti investues është projekt privat.
6. Investimi strategjik do të realizohet në Vushtrri, në zonat kadastrale: Dubovc, Kolle, Shallc, Mihaliq, Bequk, Strofc dhe Zhilivodë.
7. Pronat në të cilat do të bëhet investimi strategjik janë: Komuna e Vushtrrisë dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, respektivisht Ekonomia Pyjore.
8. Autorizohet Komisioni Ndërministror për Investime Strategjike që të negociojë marrëveshjen me subjektin investues "Cicavica Wind Farm 1 L.L.C".
9. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin ta dërgoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në rekomandimin e Grupit Operacional për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikuesit-subjektit investues "Cicavica Wind Farm 1 L.L.C" me Nr. 6969, 9148, 10000, 10309, 4071, 5176 dhe datave respektive: 21.08.2019, 11.11.2019, 11.12.2019, 23.12.2019, 17.07.2020 dhe 19.08.2020, si dhe Rekomandimin Nr. 9608 i datës 24.12.2020 të

Komisionit Ndërministor për Investime Strategjike, me të cilët konstatohet se subjekti investues "Cicavica Wind Farm 1 L.L.C" i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-079 për Investime Strategjike dhe Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 15/2018 për Mënyrën dhe Metodën e Verifikimit të Përmbushjes së Kriteve për Përcaktimin e Statusit të Investitorit Strategjik, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë